



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 24.5.2024

Nr: 49

Ora: 12:00

VENDIM
PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË PUKË, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË ALEANCA
DEMOKRATIKE SHQIPTARE”, Z.ALBAN ZEF LLESHI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 61 prot., datë 10.01.2024, Këshilli i Bashkisë Pukë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Lindita Hazir Hyseni, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Aleanca Demokratike Shqiptare.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Aleanca Demokratike Shqiptare, për Këshillin e Bashkisë Pukë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 2, z. Alban Zef Lleshi.

Me shkresën nr. 1043, prot., datë 17.4.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Pukë z. Alban Zef Lleshi, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet

Data: 24.5.2024 Nr: 49
Ora: 12:00



“Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Pukë, me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Aleanca Demokratike Shqiptare” z. Alban Zef Lleshi.”

pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia Aleanca Demokratike Shqiptare, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër SHK-AD-15251_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Alban Zef Lleshi, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit me shkresën nr. 1137 prot., datë 29. 4.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile, dhe me shkresën nr.1138 prot., datë 29. 4.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, për z. Alban Zef Lleshi.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Alban Zef Zleshi, në Këshillin e Bashkisë Pukë.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 7409/1 prot., datë 14.5.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Alban Zef Lleshi, ku konstatohet se kandidati rezulton i rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Alban Zef Zleshi, në Këshillin e Bashkisë Pukë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Pukë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Aleanca Demokratike Shqiptare , z. Alban Zef Lleshi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Iirjan CELIBASHI